

Pandemia e koronës po shkakton jo vetëm tek ju sfida të mëdha por edhe tek nëpunësit e zyrës për të huaj në lidhje me të drejtën e qëndrimit tuaj. Për fat të keq për shkak të mbrojtjes nga infektimi nuk mund të ketë kontakte në mënyrën e dëshiruar në mes tuajin dhe bashkëpunëtorëve të entit për të huaj. Që të mos keni vështirësi në aplikimin për lejeqëndrim ose vazhdimin e lejeqëndrimit juve do t'ju lëshohet një vërtetim fiktiv nga enti për të huaj. Çka do të thotë kjo për ju, ju mund ta kuptoni nga sqarimet pasuese:

Vërtetimi fiktiv

Vërtetimi është një dokument zyrtar. Me këtë dokument dëshmojnë shtetasit e vendeve të treta¹ në Gjermani, që ata posedojnë paraprakisht të drejtën e qëndrimit, nëse më parë ju keni aplikuar për dhënien e lejeqëndrimit ose vazhdimin të lejeqëndrimit tek enti përkatës për të huaj. Nëse aplikimi juaj ndodhet tek enti për të huaj juve do t'ju lëshohet një dokument për kohën deri sa të shqyrtohet aplikimi juaj për lejeqëndrim tek enti për të huaj.

Vërtetimi fiktiv aplikohet në këto raste:

1. Aplikimi i parë i lejeqëndrimit

Derisa të qëndroni në territorin federal në mënyrë të rregulltë dhe për herë të parë keni aplikuar për lejeqëndrim, juve ju vlen qëndrimi juaj si i rregulltë derisa të vendoset për aplikimin tuaj.

Deri te vendimi lidhur me aplikimin tuaj, ju nuk keni të drejtë ushtrimi të ndonjë veprimtarie. Ky vërtetim fiktiv nuk ua lejon udhëtimin nga dhe për në Gjermani.

2. Qëndrimi me një lejeqëndrim

Po që se posedoni një lejeqëndrim dhe aplikoni me kohë (dmth para skadimit të lejeqëndrimit) për vazhdimin ose lëshimin e lejeqëndrimit, atëherë lejeqëndrimi i mëparshëm vlen edhe më tutje deri tek vendimi i ri i entit për të huaj.

Me këtë vlejën edhe lejeqëndrimet e kaluara të lidhura me pasojat dhe përcaktimet plotësuese të lejeqëndrimit. Ato trajtohen asisoj sikur të kishit një lejeqëndrim të rregulltë me të gjitha pasojat ligjore. Me këtë është i lejuar edhe udhëtimi nga dhe për në Gjermani.

¹ Kjo nuk vlen për qytetarë të Bashkimit Evropian/ZEE (Zona Ekonomike Evropiane), sipas nenit 3 të marrëveshjes për lëvizje të lirë/Zvicra zviceranë me të drejtën për lëvizje të lirë dhe familjarët e tyre si dhe shtetasit turq me me lëvizje asociative.

3. RISI: Lejeqëndrimi elektronik (eAT) dhe veprimtaria sipas nenit § 81 pika 5a e Ligjit për Lejeqëndrim

Po që se enti për të huaj ka inicuar lëshimin e lejeqëndrimit elektrik (eAT) për qëndrimin tuaj lidhur me qëndrimin tuaj për një shkollim profesional ose të ushtrimit të ndonjë veprimtarie tjetër, atëherë është e lejuar kjo veprimtari në mënyrën e njëjtë siç është i paraparë me lejeqëndrim të rregulltë. Kjo leje pranohet në dokumentin fiktiv.

Kjo rregull vlen edhe në rastet e ndërrimit të punëdhënësit, në rast të vazhdimit të punësimit nga një punësim i kufizuar ose marrjes së punësimit të parë.

4. Vërtetimi i paformësuar (përmbajtësisht i krahasueshëm me vërtetimin fiktiv sipas nenit § 81 pika 4 e Ligjit për Lejeqëndrim

Po që se keni marrë një vërtetim të paformësuar nga enti për të huaj, i cili nuk ka një formë të unifikuar, atëherë ky vërtetim është i barabartë me vërtetimin fiktiv. Kjo vlen vetëm nëse në vërtetim është shënuar, që qëndrimi i juaj (dhe eventualisht punësimi i juaj në kornizat e përcaktuara në dokumentin e mëparshëm) vlen edhe më tutje si lejuar ose i toleruar.

Ky vërtetim lëshohet me kohë të kufizuar prej tre muajsh dhe përmbanë udhëzimin, që udhëtimi nga jashtë Gjermanisë nuk është i mundur.

Ju lutem të keni parasysh, se këtu është fjala për informata të përgjithshme të padetyruara lidhur me vërtetimin fiktiv sipas Ligjit për Lejeqëndrim. Po që se keni pyetje konkrete lidhur me lejeqëndrimin tuaj në Nordrhein-Westfalen atëherë drejtohuni tek enti për të huaj, që është përgjegjës për ju.